

Rroga minimum

Kategoria	01.01.23	01.07.23
1. punëtorët e pakualifikuar	Fr. 3'510	Fr. 3'520
2. punëtorët gjysëm të kualifikuar	Fr. 3'670	Fr. 3'680
4. punëtorë të kualifikuar	Fr. 3'760	Fr. 3'770
3. përgjegjësi i ekipit menaxheri	Fr. 3'940	Fr. 3'950
5. shoferë për pesha të lehta	Fr. 4'210	Fr. 4'220
6. shoferë për pesha të rënda	Fr. 4'810	Fr. 4'820
7. punëtorë të shërbimit teknik	Fr. 4'810	Fr. 4'820

Të gjitha rrogët mujore të sipërhënuara janë të llogaritura x13.

Kategoritë profesionale

- Punëtor i pakualifikuar:**
Punëtor që ekzekuton punë të thjeshta.
- Punëtor gjysëm i kualifikuar ose i njohur si i tillë nga punëdhënësi:**
Nga 15 muaj në degë.
- Përgjegjësi i ekipit, menaxheri i pastrimit:**
Punëtor i cili përgatit dhe shpërndan punën në punishte ose në lavanderi.
- Punëtor me një « CFC » ose me një formim zyrtar ekuivalent të njohur në KE (Komunitetin Evropian) ose të njohur nga punëdhënësi në funksionin e zënë:**
Punëtor që përfiton një CFC ose që njihet si i tillë nga punëdhënësi.
- Shoferi për pesha të lehta**
Punëtor me një patentë shoferi për pesha të lehta (kat. B ose B/E)
- Shoferi për pesha të rënda**
Punëtor me një patentë shoferi për pesha të rënda (kat. C ose C/E).
- Punëtor i shërbimit teknik**
Punëtor i kualifikuar i shërbimit teknik i përcaktuar për instalimin, programimin dhe riparimin e makinerive dhe pajisjeve.

Rroga e 13

Çdo punëtor ka të drejtë të marrë një rrogë të 13-të. Ajo paguhet në dhjetor. Në rast mbërritjeje ose largimi gjatë vitit ose punës me kohë të pjesshme, rroga e 13-të paguhet me prorata (e pjesshme).

Në rast punësimi me orë pune, paguhet një suplement prej 8,33% për rrogën e 13-të.

Kontributi profesional

Kontributi profesional rritet me 0,3% të rrogës së nënshtruar ndaj « LAA », dhe zbritet nga rroga mujore.

Ky kontribut u rimburohet anëtarëve të sindikatës Unia.

Rroga në rast aksidenti/sëmundje

Në rast aksidenti: 80% e rrogës gjatë gjithë per iudhës së pamundësisë për punë.

Në rast sëmundje: 80% e pagës nga dita e 3-të për nadalesa më pak se 15 ditë dhe pagesa nga dita e parë ndalimet nga 15 ditë paaftesi.

Kontrata e punës

Duhet parashtruar një kontratë pune individuale për çdo punëtor. Aty duhet shënuar kategoria profesionale, koha javore e punës, rroga dhe niveli i aktivitetit. KKP-ja është pjesë përbërëse e kontratës së punës dhe duhet t'i jepet punëtorit së bashku me kontratën. Zgjidhja e kontratës së punës duhet të komunikohet me shkrim.

Afati i pushimeve

Gjatë vitit të parë të punës, pas periudhës së provës: **1 muaj** për fundin e një muaji.

Që prej vitit të dytë dhe deri në vitin e nëntë të

shërbimit: **2 muaj** për fundin e një muaji.

Që prej vitit të dhjetë të shërbimit: **3 muaj** për fundin e një muaji.

Kohëzgjatja e punës

Kohëzgjatja e punës është fiksuar me 42.5 orë/javë ose 2220 orë/vit.

Personeli i cili është punësuar në prodhim, ka të drejtën e një pushimi me pagesë prej 15 minutash në ditë.

Orët shtesë jashtë orarit

Gjatë vitit, orët shtesë të vitit të kaluar kompensohen me një pushim me kohëzgjatje të njëjtë. Në 30 shtator të çdo viti, sahati i orëve shtesë vihet në zero. Orët shtesë që ngelen paguhet me 125%. Nëse në rast të kundërt ngelen orë negative, këto duhen fshirë.

Planifikimi i punës

Oraret e punës duhet të dorëzohen 2 javë përpara dhe duhet të specifikojnë fillimin dhe fundin e ditës së punës.

Koha e veshjes

Personat që duhet të veshin veshje mbrojtëse përfitojnë nga një kohë fikse shkëmbimi me pagesë prej 6 minutash në ditë pune.

Pushimet

- Nga 55 vjeç:

2022: 5 javë + 1 ditë

2023: 5 javë + 2 ditë

2024: 5 javë + 3 ditë

2025: 5 javë + 4 ditë

nga 2026: 6 javë

- Për të tjerët:

2022: 4 javë + 1 ditë

2023: 4 javë + 2 ditë

2024: 4 javë + 3 ditë

2025: 4 javë + 4 ditë

nga 2026: 5 javë

Për personat që përfitojnë ditë pushimi të fituara sipas vjetërsisë, në përputhje me MKP 2018-2022, këto mbahen për aq kohë sa nuk arrihet shkalla e mësipërme.

Mungesat afat-shkurtra

*martesë	2 ditë
*lindja e një fëmije	3 ditë
*vdekje (bashkëshort ose fëmijë)	3 ditë
*vdekje (babai ose nëna)	2 ditë
*vdekje (vëllai, motra, vjehri-vjehrra)	1 ditë
*shpërngulje (ndërrim banese)	1 ditë

(maksimumi një herë në vit, pas një viti në shërbim)

Në rast sëmundje të fëmijës, duke paraqitur një raport mjekësor, akordohet një pushim i paguar deri në tre ditë maksimumi.

Shtatëzania - materniteti

Dita e punës së një gruaje shtatzënë nuk duhet të tejkalojë 9 orë.

Punëtorja duhet të ketë mundësi të shtrihet dhe të pushojë në kushte të përshtatshme në vendin e saj të punës.

Punëtorja mundet të lerë punën ose të mos shkojë në punë pas një lajmërimi të thjeshtë. Përkundrazi, vetëm mungesat e justifikuara me një raport mjekësor do të paguhet.

Që prej muajit të 4-t të shtatëzanisë, punëtorja e cila punon në këmbë, ka të drejtën e një pushimi prej 10 minutash për çdo 2 orë pune. Duke filluar

nga muaji i 6-të i shtatëzanisë, ajo nuk mund të punojë në këmbë më shumë se 4 orë në ditë.

Punët e ndaluara gjatë shtatëzanisë: zhvendosje manuale në mënyrë të vazhdueshme të peshave më të mëdha se 5 kg (me raste 10 kg), lëvizje ose pozicione të lodhshme (përkulje, zgjatje së tepërmi, qëndrimi në pozicione të mbledhura, etj.), postet me goditje, lëkundje ose dridhje, punë në vende të ftohta (-5°) ose të nxehta (+28°) ose në lagështi, ekspozim ndaj radiacioneve të dëmshme ose zhurmës, ekspozim ndaj substancave ose mikro-organizmave të dëmshëm, orar pune të organizuar në mënyrë shumë të detyruese.

Rroga gjatë lejes së lindjes: 80% e rrogës gjatë 16 javëve menjëherë pas lindjes së fëmijës.

Pushimi i atësisë

14 ditë kalendarike të paguara nga 80% në përputhje me skemën e kompensimit të humbjeve të fitimeve.

Ngacmimi seksual

Ndërmarrja duhet të marrë masat e nevojshme për të parandaluar dhe dhënë fund akteve të ngacmimi seksual dhe moral në punë. Për këtë qëllim, MKP parashikon një procedurë.

Shtesat familjare

Fëmijë nën 16 vjet:

1 dhe 2 : **Fr. 300** në muaj.

nga i 3-ti fëmijë dhe per të tjerë: **Fr. 380** në muaj.
Fr. 340 për fëmijët të lindur nga 01.01.2022.

Fëmija në zanat (deri në 25 vjet maksimum):

1 dhe 2: **Fr. 360** në muaj

nga i 3-ti fëmijë dhe per të tjerë: **Fr. 440** në muaj.



Le Syndicat.



Le Syndicat.



Le Syndicat.



Le Syndicat.



Le Syndicat.

INFOS 2023

UNIA

Ditët e festave

Konsiderohen si ditë festash me pagesë:

- * 1 Janari
- * 2 Janari
- * E Premtja e Shenjtë
- * E Hëna e Pashkëve
- * Dita e ngjitjes së Krishtit në qiell
« Ascension »
- * E Hëna e Rrëshajas (zbritjes së Shpirtit të Shenjtë) « Pentecôte »
- * 1 Gushti
- * E Hëna e Agjërimit federal
- * Krishtlindja (25 dhjetor)

Nëse personeli, në mënyrë të jashtëzakonshme duhet të punojë gjatë një dite feste (ose ditën e dielë), orët e punës duhen paguar me 150%, dhe një ditë pushimi me kohëzgjatje të njëjtë me ditën e punës, duhet t'i akordohet gjatë muajit në vazhdim. Puna gjatë ditës së dielë ose gjatë ditës së festës nuk është e detyrueshme, duhet marrë paraprakisht pëlqimi i punëtorit.

UNIA

Për çdo informacion plotësues

Nëse dëshironi më tepër informacione, nëse keni nevojë për një këshillë ose nëse përballeni me një problem në kuadrin e aktivitetit tuaj profesional, mos hezitoni të na kontaktoni. Bashkëpunëtorët tanë, kompetente dhe të disponueshëm, janë në dispozicionin tuaj. Ju do të gjeni të dhënat e nevojshme për të gjitha sekretariatet e krahinës së Vaud në fund të kësaj broshure.

Les secrétariats de section Unia

**Lausanne - Crissier - Le Sentier -
Nyon - Vevey - Yverdon-les-Bains**

vaud@unia.ch

Numéro de téléphone unique:

0848 606 606

Vous pouvez nous contacter par téléphone

Le matin: lundi à vendredi de 8h30 à 12h
L'après-midi: lundi de 13h30 à 17h
Mardi et jeudi de 13h30 à 18h
Vendredi de 13h30 à 16h.

Les permanences syndicales:

Lausanne

Place de la Riponne 4 - Case postale 7667 - 1002 Lausanne

Crissier

Rue des Alpes 51 - 1023 Crissier

Le Sentier

Grand-Rue 44 - 1347 Le Sentier

Nyon

Rue de la Morâche 3 - Case postale - 1260 Nyon 1

Vevey

Avenue Paul-Cérésolle 24 - CP 267 - 1800 Vevey 1

Yverdon-les-Bains

Av. Haldimand 23 - Case postale 376 - 1401 Yverdon

Les permanences locales:

Aigle

Chemin de la Zima 2 - 1860 Aigle

Morges

Grand-Rue 73-75 - 1110 Morges

Payerne

Rue du Simplon 10 - 1530 Payerne

Vallorbe

Grand-Rue 9a - 1337 Vallorbe

Horaires des permanences:

Consultez notre site
en scannant le code QR !



La Caisse de chômage Unia

Horaires des caisses de chômage:

www.vaud.unia.ch, sous la rubrique «caisse de chômage»

Numéro de téléphone unique:

058 332 11 32

Aigle

Chemin de la Zima 2 - 1860 Aigle

aigle.cc@unia.ch

Crissier

Rue des Alpes 51 - 1023 Crissier

crissier.cc@unia.ch

Lausanne

Place Chauderon 5 - 1003 Lausanne

Fax 021 313 24 84 - lausanne.cc@unia.ch

Le Sentier (fermé le vendredi)

Grand-Rue 44 - 1347 Le Sentier

Fax 024 424 95 86 - le-sentier.cc@unia.ch

Morges

Grand-Rue 73-75 - case postale 1008 - 1110 Morges

Fax 021 811 40 79 - morges.cc@unia.ch

Nyon

Rue de la Morâche 3 - 1260 Nyon

Fax 022 994 88 56 - nyon.cc@unia.ch

Payerne

Rue des Terreaux 1 - 1530 Payerne

Fax 026 666 90 29 - payerne.cc@unia.ch

Vevey

Avenue Paul-Cérésolle 24 - case postale 267 - 1800 Vevey 1

Fax 021 925 70 09 - vevey.cc@unia.ch

Yverdon-les-Bains

Av. Haldimand 23 - case postale 376 - 1401 Yverdon

Fax 024 424 95 86 - yverdon.cc@unia.ch

CCT romande e pastrimit të tekstilit

Marrëveshje kolektive e punës (MKP) në sektorin e pastrimit të tekstilit.

Marrëveshje e re kolektive e punës (MKP) 2023-2026

Pushime

Paga të reja minimale

Rritje e pagave 2023:

+ Fr. 1110 më 1 janar 2023

+ Fr. 10 (=Fr. 120) më 1 korrik

**N° de téléphone unique du syndicat
0848 606 606**

**Syndicat Unia Vaud
www.vaud.unia.ch**